**1. Rregullore Nr. 731 datë 26.3.1993**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Annelida (Polychaetes), i njohur zakonisht si "krimba të segmentuar", gjendet në habitatet bregdetare dhe njihen si "krimba detare", përdoret përgjithësisht si karrem për peshkim. | 0106 90 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0106, 0106 90, dhe 0106 90 00.<br><br>Keto kafshe nuk konsiderohen si invertebrore ujorë, brenda kuptimit te kreut 0307. |

**2. Rregullore Nr. 2275/88 datë 25.07.1988;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkt qumështi, i përbërë nga pluhur qumështi i skremuar, që përmban: 50-100 milion për gram bakterie të gjalla të kosit (Streptococcus thermophilus dhe Bulgaricus Lactobacillus), me një përmbajtje yndyre që nuk e kalon 3%. | 0403 10 11 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, 0403 10, dhe 0403 10 11.<br><br>Ky është më tepër një produkt qumështi i kodit 0403, se sa një kulturë mikrobiale e kreut 3002. |

**3. Rregullore Nr. 1160 datë 02.06.2011;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Qumësht pluhur (0,6% yndyrë qumështi), që përmban nga 2 deri 27 milionë bacile laktike te gjalla/ për gram (Streptococcus lactus). | 0403 90 11 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, 0403 90, dhe 0403 90 11.<br><br>Ky produkt, për shkak të përqendrimit të tij të ulët të mikro-organizmave nuk mund të konsiderohet si një kulturë mikro-organizmash. |

**4. Rregullore Nr. 1533 datë 12.06.1992;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Pluhur me ngjyre të verdhë të lehtë, me shijen e qumështit pluhur, që ka karakteristikat e mëposhtëme analitike (përqindje në peshë):<br><br>Yndyrë qumështi 11.4<br><br>Yndyrna të ulëta, të ngurta të qumështit 85.9<br><br>Ujë 2.7<br><br>Proteina (N × 6.38) 30.6 | 0403 90 13 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, 0403 90, dhe 0403 90 13.<br><br>Klasifikimi në krerët 0402 dhe 0403 përjashtohet, sepse në bazë të treguesve analitikë (veçanarisht përmbajtjes së fosfolipideve), produkti ka karakteristikat e dhallës pluhur. |

**5. Rregullore Nr.775 datë 02.08.2011**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Pluhur i tharë në formë të atomizuar, pjesërisht i skremuar, i cili nuk është dekazeinuar, i paketuar për shitje me pakicë, 64 gram në një kontenier plastik me përbërjen e mëposhtme (përqindje në peshë) :<br>- yndyrë qumështi 1.2,<br>- proteina qumeshti të paktën 50 dhe zakonisht 65.5.<br>Produkti ka nje përmbajtje të lendës së thatë 93.3 % në peshë.<br>Produkti është pluhur me ngjyrë kremi, që tenton për të formuar kokriza dhe ka erë qumështi.<br>Ai ka një përmbajtje më të lartë të imunoglobulinave se sa hirra natyrale ose qumështi natyral.<br>Sipas etiketës, produkti është për konsum njerëzor. | 0404 90 21 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0404, 0404 90, dhe 0404 90 21.<br>Përjashtohet klasifikimi sipas kreut 3001 apo 3004 meqenëse produkti nuk shërben për përdorim terapeutik ose profilaktik.<br>Gjithashtu përjashtohet klasifikimi në kreun 0402, meqënese produkti nuk ka përbërjen tipike të qumështit pluhur natyral.<br>Duke patur parasysh karakteristikat e produktit, ai duhet të klasifikohet në kreun 0404. |

**6. Rregullore Nr. 902/2007  datë 27.07.2007**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Bulba e tërë e hudhres (Allium sativum), e ruajtur në një temperaturë ndëmjet 0 ° C deri në - 5 ° C, por jo e gjitha e ngrirë. | 0703 20 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi kodeve të NK 0703 dhe 0703 20 00.<br><br>Produkti përjashtohet nga kreu 0710, meqënëse ai nuk është i ngrirë në kuptim të kapitullit 7 (Shih notat spjeguese të HS të kap 7. paragrafi i tretë).<br><br>Për këtë arsye produkti do të klasifikohet në kreun 0703, si hudhër e ftohtë apo e freskët. |

**7. Rregullore Nr. 2510 datë 15.12.1997**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Grurë i qëruar (*Triticum spelta* L.), nga i cili eështë hequr lëkura (por jo perikarpi). | 1104 29 17 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar, nga shënimi 1(b) i kapitullit 10 dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1104, 1104 29, dhe 1104 29 17.<br><br>Heqja e lekurës edhe pa e dëmtuar perikarpin, e përjashton produktin nga kapitulli 10. |

**8. Rregullore Nr. 28 datë 04.01.1990;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkte në formën e një pluhuri të imët të bardhë, të përbërë nga:<br>një përzierje e niseshtesë natyrale të grurit dhe sasi të vogla niseshte gruri e acetiluar ose niseshte gruri lehtësisht e acetiluar, dhe që ka karakteristikat e mëposhtëme:<br>- p=rmbajtje niseshteje (përcaktuar me metodën Ewers) prej 95% në peshë ose më shumë,<br>- përmbajtja e acetilit (përcaktuar me metodën enzimatike) prej më pak se 0.5% në peshë në produktin e thatë. | 1108 11 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1108, dhe 1108 1100.<br>Bazuar në karakteristikat e tyre (veçanarisht në përmbajtjen e ulët të acetilit), këto produkte konsiderohen si niseshte në kodin 1108 11 00 dhe jo si niseshte e modifikuar me anë të esterifikimit në kodin :<br>3505 10 50. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkte në formën e një pluhuri të imët të bardhë, të përbërë nga:<br>një përzierje e niseshtesë natyrale së misrit të dhe sasi të vogla niseshte e acetiluar misri ose niseshte misri lehtësisht e acetiluar, dhe që ka karakteristikat e mëposhtëme:<br>- permbajtje niseshteje (përcaktuar me metodën Ewers) prej 95% në peshë ose më shumë,<br>- përmbajtja e acetilit (përcaktuar me metodën enzimatike) prej më pak se 0.5% në peshë në produktin e thatë. | 1108 12 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1108, dhe 1108 12 00.<br>Bazuar në karakteristikat e tyre (veçanarisht në përmbajtjen e ulët të acetilit), këto produkte konsiderohen si niseshte në kodin 1108 12 00 dhe jo si niseshte e modifikuar me anë të esterifikimit në kodin 3505 10 50. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkte në formën e një pluhuri të imët të bardhë, të përbërëa nga:<br>një përzierje e niseshtesë natyrale të patates dhe sasi të vogla të niseshtesë të acetiluar të patates ose të niseshtesë lehtësisht të acetiluar të patates, dhe që ka karakteristikat e mëposhtme:<br>- përmbajtje niseshteje (përcaktuar me metodën Ewers) prej 95% në peshë ose më shumë,<br>- përmbajtja e acetilit (përcaktuar me metodën enzimatike) prej më pak se 0.5% në peshë në produktin e thatë. | 1108 13 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1108, dhe 1108 13 00.<br>Bazuar në karakteristikat e tyre (veçanarisht në përmbajtjen e ulët të acetilit), këto produkte konsiderohen si niseshte në kodin 1108 13 00 dhe jo si niseshte e modifikuar me anë të esterifikimit në kodin 3505 10 50. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkte në formën e një pluhuri të imët të bardhë, të përbëra nga:<br>një përzierje e niseshtesë natyrale të maniokes dhe sasi të vogla niseshte e acetiluar manioke ose niseshte lehtësisht e acetiluar manioke, dhe që ka karakteristikat e mëposhtëme:<br>- permbajtje niseshteje (përcaktuar me metodën Ewers) prej 95% në peshë ose më shumë,<br>- përmbajtja e acetilit (përcaktuar me metodën enzimatike) prej më pak se 0.5% në peshë në produktin e thatë. | 1108 14 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1108, dhe 1108 14 00.<br>Bazuar në karakteristikat e tyre (veçanarisht në përmbajtjen e ulët të acetilit), këto produkte konsiderohen si niseshte në kodin 1108 14 00 dhe jo si niseshte e modifikuar me anë të esterifikimit në kodin :<br>3505 10 50. |

**9. Rregullore Nr. 1160 datë 02.06.1998;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Përzierje e laktozës, kazeinës, albuminës, globulinës dhe yndyrës së qumështit që përmbajnë mikroorganizma sporagjene (Lactobacillus e Streptococcus pentosus lactus 50 – 100 million për gram), në formën e një pluhuri me karakteristikat e mëposhtëme (% në peshë)<br>- laktozë : 39,<br>- kazeinë : 22,<br>- albuminë / globulinë të qumështi 4,<br>- hiri: 6,<br>- yndyrë qumështi: 24,<br>- ujë: 5 | 0403 90 13 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, dhe 0403 90dhe 0403 90 13.<br><br>Ky produkt, për shkak të përqëndrimit të tij të ulët në mikro-organizma, nuk mund të konsiderohet si një kulturë mikro-organizmash. |

**10. Rregullore Nr.1160 datë 02.06.1998**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkt, i përbërë nga qumështi pluhur, me shtesa të fermenteve laktike (Streptococcus lactus dhe Lactobacillus, përafërsisht 150 milion për gram) dhe maja laktike jo të gjallë (Kluveromyces lactis dhe fragilis), me karakteristikat e mëposhtëme (% në peshë):<br>- proteina: 28,<br>- lëndë e thatë: 95-96,<br>- yndyrë qumështi: 25,<br>- laktozë: 39<br>Ky produkt, për shkak të përqendrimit të tij të ulët në mikro-organizëm nuk mund të konsiderohet si një kulturë mikro-organizmash. | 0403 90 13 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, dhe 0403 90 dhe 0403 90 13.<br><br>Ky produkt, për shkak të përqëndrimit të tij të ulët në mikro-organizma, nuk mund të konsiderohet si një kulturë mikro-organizmash. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Përzierje e përbërësve të qumështit, me 2% shtesa të klorurit të natriumit dhe të citratit të natriumit, 0.2% vitamina, me karakteristikat emëposhtme (% në peshë):<br>- lënde të thatë: 95,<br>- laktozë: 56.5<br>- proteina: 28.8,<br>- yndyrë qumështi: 1.1,<br>- hiri: 8. | 0404 90 21 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi kodeve të NK 0403, 0403 90 dhe 0403 90 21.<br><br>Ky produkt nuk mund të konsiderohet si një kulturë e pergatitur për zhvillim të mikro-organizmave |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Përzierje e përbërësve të qumështit, me shtesa te klorurit te natriumit dhe të citratit të natriumit 4.5%, vitamina 0.2%, me karakteristikat e mëposhtme (% në peshë):<br>- lendë e thatë: 96.2,<br>- laktozë: 59.7,<br>- proteina: 23.3,<br>- yndyrë qumështi: 23.3,<br>- hiri: 11.5. | 0404 90 21 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi kodeve të NK 0403, 0403 90 dhe 0403 90 21.<br><br>Ky produkt nuk mund të konsiderohet si një kulturë e pergatitur për zhvillim të mikro-organizmave |

**11. Rregullore Nr.314 datë 05.02.1990**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Bllok i ngrirë fileto e gjoksit të pulës, i futur në bujon të bërë me kockat e mishit të pulës, perime dhe pluhur supe. Blloqet peshojnë rreth 15 kg dhe përmbajnë afërsisht sasi të njëjta të fileto dhe të bujonit. | 1602 32 30 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1602, 1602 32 dhe 1602 32 30.<br><br>Fakti që filetot janë vendosur në bujon e përjashton atë nga kapitulli 2, (Shih notat spjeguese të Sistemit të Harmonizuar të kapitullit 2, ‘‘Dallimi midis mishit dhe të brendëshmeve të mishit të këtij kapitulli dhe atyre të kapitullit 16, paragrafi i parë’’<br>Produkti nuk është një përgatitje për të bërë supë ose bujon, ne kuptimin e kodit 2104 10 00 (Shih notat spjeguese te HS, kreun 2104, pika A, paragrafi i pare). |

**12. Rregullore Nr. 227 datë 09.02.2006;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti përbëhet nga (% në peshë)<br>- sukroze: 99.05,<br>- acid citrik: 0.95 | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br><br>Produkti nuk mund të konsiderohet si sheqer bruto në kuptim të shënimit shtesë Nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br><br>Produkti duhet klasifikuar si sheqer tjetër në nënkreun 1701 99 90 |

**13. Rregullore Nr. 227 datë 09.02.2006;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti përbëhet nga (% në peshë)<br>- sukroze: 99.5,<br>- acid citrik: 0.5. | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br>Produkti nuk mund të konsiderohet si sheqer i bardhë, në kuptim të shënimit shtesë nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br>Produkti klasifikohet si sheqer tjetër në nënkreun 1701 99 90 |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti perbehet nga (% në peshë)<br>- sukroze: 99.05,<br>- acid citrik: 0.4,<br>- acid askorbik: 0.1 | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90 të NK.<br>Produkti nuk mund të konsiderohet si sheqer i bardhë, në kuptim të shënimit shtesë Nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br>Produkti klasifikohet si sheqer tjetër në nënkreun 1701 99 90 |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti perbehet nga (% në peshë)<br>- sukroze: 99.7,<br>- acid citric: 0.2,<br>- acid askorbik: 0.1. | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br>Produkti nuk mund të konsiderohet si sheqer i bardhë në kuptim të shënimit shtesë nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br>Produkti duhet klasifikuar si sheqer tjetër në nënkreun 1701 99 90. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti përbëhet nga (% në peshë)<br>- sukrozë: 97.5,<br>- gjalpë kakao: 2.5<br>Ky produkt konsiston në një pluhur kristalin të bardhë, të ëmbel, të ngjashëm me sheqerin e bardhë komercial. | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br>Produkti nuk mund të konsiderohet si sheqer bruto në kuptim të shënimit shtesë nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br>Produkti klasifikohet si sheqer tjeter në nënkreun 1701 99 90, meqënëse gjalpi i kakaos, nuk mjafton për të ndryshuar karakteristikat e sheqerit. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti perbehet nga (% në peshë)<br>- sukroze: 97.7,<br>- klorur natriumi: 2.3<br><br>Ky produkt paraqitet në formën e një pluhuri kristalin, të bardhë, të ëmbël dhe lehtësisht të kripur.<br><br>Ai përbëhet kryesisht nga kristale sukroze me kristale të rralla, në formë kubike të klorurit të natriumit. | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br><br>Produkti konsiston në një përzierje në formë kristalesh të sheqerit dhe të klorurit të natriumit. Ai nuk mund të konsiderohet si sheqer bruto në kuptim të shenimit shtesë nr.1 të kapitullit 17 të NK.<br><br>Produkti duhet klasifikuar si sheqer tjetër në nënkreun 1701 99 90. Prania e sasive të vogla të klorurit të natriumit (2.3 % në peshë), nuk ndryshon karakteristikat e produktit si sheqer i kapitullit 17 të NK. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Produkti përbëhet nga (% në peshë)<br>- sukrozë: 95,<br>- laktozë: 2.5 | 1701 99 90 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br><br>Produkti duhet klasifikuar si sheqer tjeter në nënkreun 1701 99 90, meqënese përmbajtja e laktozës nuk ndryshon karakteristikat e produktit si sheqer i kapitullit 17 të NK. |

**14. Rregullore Nr. 447 datë 27.05.2009;**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Shurup sheqeri i invertuar, i përbërë (% në peshë):<br>- sheqer (shprehur si saharoze): 66,5<br>- Uje: 31,<br>- propilen glikol: 2.5.<br>Produkti përdoret mes të tjerash, në industrinë e duhanit si një substancë njomëse dhe është rifuxho. | 1702 90 95 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 1701, 1701 99 dhe 1701 99 90.<br>Shtimi i propilen glikolit në sasinë e dhënë, nuk ndryshon karakterin e produktit, në një masë të tillë që ai të konsiderohet si një produkt kimik i kreut 3824.<br>Produkti ka karakterin e një shurupi sheqeri të kreut 1702. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Pluhur me ngjyre të verdhë të lehtë, me shijen e qumështit pluhur, që ka karakteristikat e mësipërme analitike (% në peshë):<br>Yndyrë qumështi 11.4<br>Yndyrna të ulëta, të ngurta të qumështit 85.9<br>Ujë 2.7<br>Proteina (N × 6.38) 30.6<br>Laktozë 42.9<br>Fosfolipide (P × 26) (si % e përmbajtjes së yndyrës) 17<br>Produkti është tregtuar me emrin ‘‘dhallë pluhur e pasuruar me yndyrë qumështi’’. | 0403 90 13 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0403, 0403 90, dhe 0403 90 13.<br>Përjashtohet klasifikimi në krerët 0402 dhe 0403, sepse në bazë të treguesve analitikë (veçanarisht përmbajtjes së fosfolipideve), produkti ka karakteristikat e dhallës pluhur. |

**15. Rregullore Nr.717 datë 19.03.1985**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Pastile (tableta) për kollën dhe dhimbjen e fytit, me përbërje ndaj peshës: 99.5% saharoze, glukozë dhe karamel, 0.007% kamfor, 0.207% mente, 0.069% eukalipt, 0.003% balsam Tolu, 0.069% timol dhe 0.138% alkool benzilik. | 1704 90 55 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar dhe nga përshkrimi i kodeve NK 0404, 0404 90, dhe 0404 90 21.<br><br>Klasifikohet në nënkreun 1704, sheqeri i konfeksionuar, që nuk përmban kakao. |

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikulli konsiston në një pëlhurë tekstile të endur (100% pambuk), jo të zbardhur, drejtkëndëshe, me përmasa afërsisht 180 x 90 cm, me anët e kthyera përgjatë gjerësisë dhe anët e veta përgjatë gjatësisë.<br>(shtresë krevati)<br><br>(Shih figurën 638) | 6302 31 00 | Klasifikimi përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenkalturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 7(c) të Seksionit XI, Shënimit 1 të Kapitullit 63, përshkrimit të kreut 6302 dhe kodit 6302 31 00.<br><br>Artikulli është i ndërtuar siç përcaktohet në shënimin 7(c) të Seksionit XI për arsye se dy prej anëve të tij janë të kthyera.<br><br>Duke marrë parasysh veçoritë e artikullit si: të qënit i përshtatshëm për larje, përmasat dhe materiali përbërës i tij, ky artikull zotëron karakteristikat e shtresave të krevatit. Kjo përforcohet edhe prej faktit se kur fiksohet gjatë gjithë gjerësisë së dyshekut ai e mbron atë nga konsumimi normal. Prandaj, ky artikull konsiderohet si shtresë krevati sipas kuptimit të kodit 6302 31 00.<br><br>Shih gjithashtu Notat Shpjeguese të Kreut 6302, paragrafi i pare dhe (1). |




**16. Rregullore Nr. 781/2006, date 24.05.2006**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikulli në fjalë është një kuti kartoni, e fortë, me kapak të ndarë (pa kapëse), me sipërfaqe të jashtme të të dy komponentëve përbërës prej letre. Përmasat e kutisë janë 5.5 cm (gjatësia) x 4.5 cm (gjerësia) x 3 cm (lartësia). Në kuti ka një fjongo zbukuruese prej tekstili.<br>Kutia është e pajisur me një sfungjer sintetik të lëvizshëm me trashësi 1 cm. Sfungjeri është prej plastike celulare, pjesa e sipërme e të cilit është e mbuluar me një shtresë prej materiali tekstil, e mbuluar kjo me një imitim pushi tekstil. Në qëndër ka një prerje gjysëm rrumbullake tejpërtej sfungjerit, prerje që është dizenjuar për të mbajtur një stoli të çmuar, p.sh. një unazë.<br>(Kuti bizhuterie)<br><br>(Shih figurat 637 A dhe 637 B) | 4202 99 00 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(h) të Kapitullit 48, përshkrimit të kreut 4202 dhe kodit 4202 99 00 të NK.<br>Fortësia e kartonit tregon që artikulli është në gjëndje të përdoret për një kohë të gjatë. Për më tepër, përmasat e sfungjerit (trashësia e tij e përshtatshme për kutinë), pamja e tij e jashtme (e ngjashme me pëlhurat me push) dhe mbi të gjitha skicimi i të çarës e bën këtë artikull një kontenier me kapak, të ngjashëm me 'kutitë e stolive të çmuara' të përshtatshme për të mbajtur një stoli të çmuar (Notat Shpjeguese të kreut 4202, pragrafi i shtatë).<br>Për më tepër, artikulli mbulohet me letër e cila plotëson kërkesat për kontenierët e përmëndur në pjesën e dytë të përshkrimit të |

| | | |
|---|---|---|
| | | kreut 4202.<br>Duke marrë parasysh karakteristikat e tij (karton i fortë, veçoritë specifike të sfungjerit) artikulli është dizenjuar për të ruajtur një mall të veçantë siç janë stolitë e çmuara. Si rrjedhim, këtë artikull e gjejmë të përmëndur në pjesën e dytë të përshkrimit të kreut 4202 dhe si i tillë në përputhje me Notat Shpjeguese 2(h) të Kapitullit 48 ai përjashtohet nga Kapitulli 48. [Shih gjithashtu frazën e parë të paragrafit të parë të Notave Shpjeguese të HS për kreun 4819 (A).] |






**17. Rregullore Nr. 336/2010 datë 21.04.2010**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikulli paraqitet në formën e një disku me diametër afërsisht prej 580 mm dhe me një trashësi afërsisht prej 2 mm. Ky artikull përbëhet nga 2 shtresa prej shajaku sintetik, njëra prej të cilave është e ngopur me lidhës polimerik (poliuretan) (e ashtëquajtur 'mbushje poromerike'). Shtresa tjetër ka një mbulues adesiv që mbrohet nga një fletë plastike e ndashme.<br>Artikulli përdoret në makineritë e prodhimit të silikonit dhe vaferëve gjysëmpërçues. Vendoset në kokën transportuese të një vegle të këmbyeshme të këtyre makinerive dhe përdoret për të zdrukthtuar/rrafshuar dhe lëmuar vaferët. | 5911 90 90 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 7(a) të Seksionit XI, Shënimit 1(e) të Seksionit XVI, Shënimit 7(b) të Kapitullit 59 dhe sipas përshkrimit të kreut 5911, nënkreut 5911 90 dhe kodit 5911 90 90 të NK.<br>Përjashtohet klasifikimi i këtij artikulli në kreun **8486** si pjesë apo aksesor i një makine e një lloji të përdorur vetëm apo kryesisht për prodhimin e vaferëve gjysëmpërçues sepse ky artikull nuk ka karakteristikat për tu konsideruar si pjesë apo aksesor i një makinerie të tillë.<br>Produkti formon një artikull për përdorim teknik brenda kuptimit të Shënimit 1(e) të Seksionit XVI, meqenëse ai përdoret me makineritë për prodhimin e silikonit dhe vaferëve gjysëmpërçues për të zdrukthtuar/rrafshuar dhe lëmuar vaferët.<br>Si rezultat ky artikull klasifikohet në kodin tarifor 5911 90 90 të NK si një artikull prej materiali tekstil ( materiali përbërës) i përdorur për qëllime teknike (Shih Shënimin 7 (b) të Kapitullit 59). |

**18. Rregullore e Nr. 1966/94, datë 28.07.1994**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Tapet i vogël për pastrimin e këmbëve me sipërfaqe të jashtme që konsiston në tufa të fibrave të arrës së kokosit, rreth 1 cm në gjatësi, të futura në mënyrë të drejtpërdrejtë vertikalisht, në një shtresë PVC të përzierë me një plastifikues. | 5705 00 80 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe prej përshkrimit të kreut 5705 dhe kodit 5705 00 80 të NK.<br>Shih gjithashtu dhe Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar, kreu 5705. |

**19. Rregullore e Nr. 692/2010, datë 30.07.2010**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikull në formë gjysmërrethi, i trashë, me përmasa të përgjithshme afërsisht 75 cm x 45 cm. Artikulli përbëhet nga pëlhurë tekstile e endur prej fibrave të dredhura të arrës së kokosit, të cilat formojnë pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe me sipërfaqen mbështetëse prej gome. Ky artikull është i rrethuar nga një bordurë zbukuruese prej gome.<br>(fshirëse këmbësh)<br>(Shih figurën 652) | 5702 20 00 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1, 3(b) dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(a) të Kapitullit 40, Shënimit 1 të Kapitullit 46, Shënimit 1 të Kapitullit 57, përshkrimit të kreut 5702 dhe kodit 5702 20 00 të NK.<br>Fibrat e arrës së kokosit janë fibra vegjetale tekstili të cilat kur dridhen i përkasin kreut 5308 dhe si rezultat përfShihen në Seksionin e XI (tekstilet dhe artikujt tekstilë) të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.<br>Sipërfaqa e artikullit është e përbërë prej pëlhure të endur nga fijet e fibrave të arrës së kokosit dhe prej gomës, por në këtë rast fibrat e arrës së kokosit i japin karakterin thelbësor sipërfaqes, sipas kuptimit të Rregullit 3(b), për arsye se ju lejon njerëzve të |

| | | |
|---|---|---|
| | | pastrojnë apo të fshijnë shuallin e kepucëve të tyre dhe veç kësaj fibrat e arrës së kokosit formojnë pjesën më të madhe të sipërfaqes.<br>Përderisa materiali tekstil (pëlhura e endur prej fijeve të fibrave të arrës së kokosit) shërben si një sipërfaqe e ekspozuar e artikullit kur ai është në përdorim, ky artikull është një ‘mbulues dyshemeje tekstili’, sipas kuptimit të Shënimit 1 të Kapitullit 57.<br>Për shkak të përmasave të tij, trashësisë, ngurtësisë dhe fortësisë, artikulli ka karakteristikat e një mbuluesi tekstil dyshemeje.<br>Për më tepër, teksti i kreut 5702 përfshin ‘të tjerë mbulues tekstil të dyshemesë, të endur’ pa ndonjë dallim përsa i përket prodhimit të tyre për përdorim brenda apo jashtë shtëpisë dhe pa specifikuar përmasat.<br>Si rezultat, në përputhje me Shënimin 2(a) të Kapitullit 40, ky artikull nuk mund të klasifikohet në Kapitullin 40, sepse ky Kapitull nuk përfshin mallrat e Seksionit XI (teksilet dhe artikujt tekstilë).<br>Ky artikull nuk mund të klasifikohet as në Kapitullin 46 për arsye se sipas Shënimit 1 të tij, ky Kapitull nuk përfshin fibrat natyrale tekstile të dredhura.<br>Ky artikull klasifikohet si një mbulues dyshemeje tekstili në Kapitullin 57 të NK së Mallrave. |




| (1) | (2) | (3) |
|---|---|---|
| Artikull me formë drejtëkëndëshi, i trashë, me përmasa përafërsisht 60 cm x 40 cm, i përbërë nga fibra të arrës së kokosit që formojnë një sipërfaqe me push. Fibrat e arrës së kokosit janë të lidhura tek një substrat prej polivinil kloridi, i cili formon pjesën mbështetëse të artikullit. Fshirësja e këmbëve është e rrethuar nga një bordurë zbukuruese polivinilkloridi.<br>(Fshirëse këmbësh).<br><br>(Shih figurën 653) | 5705 00 80 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1, 3(b) dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(p) të Kapitullit 39, Shënimit 1 të Kapitullit 57, përshkrimit të kreut 5705 dhe kodit 5705 00 80 të NK.<br>Fibrat e arrës së kokosit brenda qëllimit të kreut 5305 janë fibra vegjetale tekstili dhe si rezultat i përkasin Seksionit të XI (tekstilet dhe artikujt tekstilë) të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.<br>Sipërfaqja e artikullit është e përbërë prej fibrave të arrës së kokosit dhe polivinil kloridit, por sipas kuptimit të rregullit 3(b) fibrat e arrës së kokosit i japin karakterin thelbësor sipërfaqes, për arsye se kjo ju lejon njerëzve të pastrojnë apo të fshijnë shuallin e kepucëve të tyre.<br>Përderisa materiali tekstil (fibrat e arrës së kokosit) shërben si një sipërfaqe e ekspozuar e artikullit kur ai është në përdorim, ky artikull është një ‘mbulues dyshemeje tekstili’, sipas kuptimit të Shënimit 1 të Kapitullit 57. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Për shkak të përmasave të tij, trashësisë, ngurtësisë dhe fortësisë artikulli ka karakteristikat e një mbuluesi tekstil dyshemeje.<br>Për më tepër, kreu 5705 mbulon qilimat dhe mbuluesit tekstil të dyshemesë, pa ndonjë dallim përsa i përket prodhimit të tyre për përdorim brenda apo jashtë shtëpisë dhe pa specifikuar përmasat (Shih gjithashtu Notat Shpjeguese të kreut 5705, paragrafi i parë). Ky kre përfshin qilimat me push të lidhur, ku pushi në sipërfaqe lidhet tek një substrat apo direkt tek një adhesivë i cili formon substratin (Shih Notat Shpjeguese të HS, kreu 5705, paragrafi i dytë (1)).<br>Si rezultat, mbështetur në Shënimin 2 (p) të Kapitullit 39, artikulli në fjalë nuk mund të klasifikohet në Kapitullin 39, sepse ky Kapitull nuk përfshin artikujt e Seksionit XI (teksilet dhe artikujt tekstilë).<br>Prandaj ky artikull klasifikohet si një mbuluess dyshemeje tekstili në Kapitullin 57 të NK së Mallrave |



**20. Rregullore Nr. 1020/2003, datë 13/06/2003**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Mbulues njëngjyrësh, që lahet (afërsisht 73 cm x 42 cm), i prodhuar nga një produkt tekstili shumështresash me tegela. Shtresa e jashtme konsiston në një pëlhurë të endur (65% poliester, 25% pambuk dhe 10% polipropilen), shtresa e mesme e mbushjes dhe shtresa e brëndshme prej pëlhure njëngjyrëshe jo të endur (100% polipropilen). Eshtë i pajisur me një zinxhir për të lejuar mbushjen e tij.<br>(Këllëf jastëku)<br>(Shih figurën 627) | 6302 32 90 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(A) dhe 7 të Seksionit XI, Shënimit 2(A) të nënkreut të Seksionit XI, Shënimit 1 të Kapitullit 63 dhe sipas përshkrimit të kreut 6302, nënkreut 6302 32 dhe kodit 6302 32 90 të NK.<br>Tekstili shumështresash me tegela është i ndërtuar nga një produkt i kreut 5811. Shiko gjithashtu Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 5811<br>Sipas kuptimit të kreut 6302 ky artikull kosiderohet si shtresa krevati. Shiko gjithashtu Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 6302 (1), i cili përfshin këllëf jastëku brenda kreut 6302.<br>Përjashtohet klasifikimi nën kreun 9404 (artikujt shtresa dhe mbulesa) meqënse ky artikull nuk është i mbushur apo pajisur në brendësi me ndonjë material tjetër. Shih gjithashtu Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 9404 (B). Për më tepër Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar të kreut 9404 (e) përjashtojnë këllëfët e jastëkëve nga ky kre dhe i klasifikojnë ato në kreun 6302. |


627

**21. Rregullore Nr. 92/97 e datës 20.01.1997**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikulli konsiston në një sfungjer plastik të mbuluar në njërën anë me sisal të thurur me një file dhe në anën tjetër me pëlhurë me laqe (prej pambuku). Përdoret për të masazhuar trupin. Ka një shirit elastik për ta bërë të përdorshëm në dorë. (Shtresa tualeti) | 6302 99 90 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1, 3(b) dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(A) të Seksionit XI dhe sipas përshkrimit të kreut 6302 dhe kodit 6302 99 90 të NK. Shiko gjithashtu Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 6302. |
| Shirit i gjërë (60 x 12 x 12 cm), që konsiston në fibra rami të thurura me një file (që predominojnë në peshë), dhe pambuku me një shtresë të ndërmjetme prej sfungjeri plastik. Përdoret për të masazhuar trupin. Shiriti ka një fije në secilën pjesë fundore që e bën atë të përshtatshme për përdorim. (Shtresa tualeti) | 6302 99 90 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1, 3(b) dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, Shënimit 2(A) të Seksionit XI, përshkrimit të kreut 6302 dhe kodit 6302 99 90 të NK. Shiko gjithashtu Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 6302. |

**22. Rregullore Nr. 652/2007, datë 08.06.2007**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
| Artikull i ashtëquajtur ‘dyshek i vetë-fryrshëm’ me qëllim përdorimi në ambiente jashtë shtëpie, me përmasa: 185 cm (L), 66 cm (W) dhe 3.8 cm (H). Sipërfaqja e jashtme e artikullit përbëhet nga një pëlhurë tekstile prej fibrash sintetike e veshur në | 6306 40 00 | Klasifikimi i këtij artikulli përcaktohet nga Rregullat e Përgjithshme 1 dhe 6 të Interpretimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, përshkrimit të kreut 6306 dhe kodit 6306 40 00 të NK. Për shkak të karakteristikave të tij |

| | | |
|---|---|---|
| pjesën e brendëshme me plastikë. Kjo e fundit përbëhet nga një fletë (me trashësi afërsisht 3.5 cm) prej sfungjeri poliuretani me qeliza të hapura.<br>Sipërfaqja e jashtme e këtij artikulli është e përforcuar për ta mbrojtur nga fërkimi me produkte të tjera (p.sh. thes gjumi) dhe është jetëgjatë, rezistente ndaj kontaktit me tokën, lagështisë dhe shpimit.<br>Ky artikull është i pajisur me një valvul e cila lejon futjen e ajrit kur dyshkeu hapet dhe daljen e tij kur dysheku mblidhet. | | (rezistent ndaj fërkimit, kontaktit me tokën, jetëgjatësisë) dhe faktit që përdoret në ambiente jashtë shtëpie ky produkt bën pjesë tek mallrat për kamping.<br>Ky produkt përjashtohet nga Kapitulli 94 për arsye se artikulli është një dyshek pneumatik (shiko Shënimin 1(a) të Kapitullit 94).<br>Ky produkt klasifikohet në nënkreun 6306 40 00 si një artikull kampingu, si dyshek pneumatik prej tekstili. |

23. **Rregullore Nr. 428 datë 27.04.2011**

| Përshkrimi i mallrave | Klasifikimi (Kodi NK) | Arsyet |
|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) |
